

VENDIM
Nr.4, datë 16.1.2012

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES “HEC KLOS” TË SHOQËRISË “MALIDO ENERGJI” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “l”, 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2, germa “a”, të rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Klos” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k., është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrik nga burimet e rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 4, germa “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kualifikimin e impiantit prodhues “Hec Klos” të shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. si burime të rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani